

# **ADRESIMI I PËRGJEGJËSISË**

## **NJOHURITË E QYTETARËVE ME KOMPETENCAT E KOMUNAVE**



**Mars 2017**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e **Institutit GAP** dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

## Përmbledhje ekzekutive

Gjatë fushatave zgjedhore, kandidatët për kryetarë komunash japin premtime edhe në fushat të cilat nuk bien në kompetencat vetanake të komunave. Në të kaluarën janë dhënë premtime për zgjidhjen e problemit të energjisë elektrike, hapjen e fabrikave për punësim, hapje të aeroportit, etj. Pas marrjes së mandatit, kryetarët shpesh ankohen se prej tyre po kërkohet më shumë llogari se sa që kanë kompetenca. Me qëllim të matjes së njohurive të qytetarëve për kompetencat e komunave, Instituti GAP ka bërë një anketë me qytetarë, të cilët janë pyetur për çështje të ndryshme të shërbimeve publike, nga menaxhimi i mbeturinave e deri tek nxjerrja e dokumenteve personale.

Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme për institucionet përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të ndryshme publike. Për shembull, mbi 85% e qytetarëve e dinë se menaxhimi i mbeturinave është kompetencë e komunës dhe kompanisë rajonale për menaxhim të mbeturinave. Afër 80% e qytetarëve janë në dijeni se furnizimi me ujë është kompetencë e kompanisë rajonale për furnizim me ujë, kurse vetëm 13.3% mendojnë se kjo është kompetencë vetëm e komunës.

Por, janë disa fusha ku qytetarët nuk kanë njohuri të mjaftueshme për ndarjen e kompetencave në mes të nivelit qendror dhe atij lokal. Në disa raste, qytetarët gabimisht i lënë përgjegjësi nivelit qendror për çështjet që janë në kompetencë të komunës. Një shembull i tillë është përzgjedhja e mësimdhënësve në shkolla. Afër 49% e qytetarëve janë të mendimit se kjo është kompetencë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kurse 33.5% janë në dijeni se kjo është kompetencë vetanake e komunave. Në disa raste tjera, qytetarët mbajnë përgjegjësi komunën për çështje që bien në kompetencë të nivelit qendror. Të pyetur se në cilin institucion duhet aplikuar për t'u pajisur me letërnjoftim dhe pasaportë, mbi 50% e të anketuarve mendojnë se adresa për këtë është komuna, kurse 34.3% janë në dijeni se adresa e saktë është Ministria e Punëve të Brendshme.

Bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi, Instituti GAP në bashkëpunim me institucionet qendrore, do të ndërmar një kampanjë për të informuar qytetarët për kompetencat e komunave. Njëkohësisht besojmë se rezultatet e këtij hulumtimi do të shërbejnë si mësim për kandidatët për kryetarë komunash që fushatën e tyre ta orientojnë në ato fusha që bien në kompetencë të komunave; si dhe shpresojmë se institucionet e nivelit qendror sa më parë do të fillojnë zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale, e cila parasheh shqyrtimin e ligjeve të cilat kanë krijuar konflikt kompetencash në mes të dy niveleve të qeverisjes.

# 1. Hyrje

“Kryetarët e komunave kanë më shumë përgjegjësi, se sa të drejta (kompetenca) për zgjidhjen e çështjeve që i preokupojnë qytetarët.” Ky është një ndër refrenet që përsëritet shpesh nga kryetarët e komunave, sa herë ata sfidohen për shërbimet publike, siç janë furnizimi me ujë, grumbullimi i mbeturinave, ruajtja e pyjeve apo shtretërve të lumenjve.

Në anën tjetër, gjatë fushatave zgjedhore, kandidatët për kryetarë komunash japin premtime për zgjidhjen e problemeve që nuk bien në kompetencë të komunave apo për zgjidhjen e të cilave ekziston një ndërthurje kompetencash në mes të nivelit qendror dhe lokal. “Do ta largoj barrieren mbi urën e Ibrit”, premtonte kryetari aktual i Komunës së Mitrovicës z.Agim Bahtiri, për një problem i cili ishte shndërruar në temë dialogu mes Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë. “Brenda 24 muajsh, qytetarët e Prishtinës do të kenë ujë 24 orë”, ishte premtimi i kryetarit aktual të Komunës së Prishtinës z.Shpënd Ahmeti, për një problem disa vjeçar të Prishtinës, zgjidhja e të cilit kërkon një bashkërendim të përpjekjeve në mes të komunës dhe qeverisë. “Do të hapim aeroportin e Gjakovës”, premtonte kryetarja aktuale e Komunës së Gjakovës znj.Mimoza Kusari-Lila, ani pse kjo bie në kompetencë të nivelit qendror dhe ishte pikërisht ajo që në cilësinë e ministres ishte marrë me këtë çështje, deri në dorëheqjen e saj për të garuar për kryetare të komunës.

Në të njëjtën mënyrë, niveli qendror akuzon komunat sa herë paraqitet një problem i pa zgjidhshëm, kurse vrapon në marrjen e meritave sa herë zgjidhet ndonjë problem. “Ky është projekti më i rëndësishëm që e ka mbështet Qeveria në Komunën e Prishtinës”, deklaroi ministri i Ministrisë së Financave z.Avdullah Hoti në përrurimin e 15 autobusëve të rinj urban të Prishtinës<sup>1</sup>, marrëveshje e cila ishte bërë e mundur pas shumë akuzave në mes të komunës dhe qeverisë dhe pas një peticioni të gjerë të qytetarëve i cili përshpejtoi nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Pas marrjes së mandatit, kryetarët e komunave fillojnë të ankohen se qytetarët kërkojnë prej tyre më shumë se sa që ata kanë kompetencë. Njëkohësisht, fillojnë akuzat në mes të nivelit qendror dhe lokal për pengim në kryerjen e punëve. E qytetarët zhgënjehen me përfaqësuesit e tyre të cilët nuk arrijnë të adresojnë problemet kryesore me të cilat përballen ata.

---

<sup>1</sup> Lajmi.net. Hoti: Autobusët e rinj, projekti më i rëndësishëm që e ka mbështet qeveria. Publikuar më 11 janar 2017. Burimi: <http://bit.ly/2n8ZPC4> (hapur së fundmi më 21 mars 2017).

Nga aspekti ligjor, ekziston një ndërthurje dhe konflikt kompetencash në mes të dy niveleve. Sipas Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 “një ndarje jo shumë e saktë e kompetencave të nivelit lokal dhe qendror, eliminimi i dy-shkallshmërisë në procesin administrativ në komuna, mos harmonizimi dhe kundërthëniet ndërmjet ligjeve, kanë qenë disa nga çështjet sfiduese për komunat, në vitet e kaluara. Prandaj, kjo strategji do të propozojë alternativat për të rregulluar çështjet ligjore në mënyrë efektive dhe për të krijuar një sistem unik dhe të qëndrueshëm në kuadër të rendit juridik të shtetit”.

Duke u bazuar në këtë, Instituti GAP ka ndërmarr një hulumtim të gjerë qëllimi i të cilit është: 1. Matja e njohurive të qytetarëve për përgjegjësinë e komunave karshi problemeve të tyre; 2. Avokim për ndryshimin e bazës ligjore me qëllim të qartësimit të kompetencave dhe adresimit të përgjegjësisë; 3. Edukimin e qytetarëve për kompetencat dhe përgjegjësitë e komunave karshi tyre; dhe 4. Ndhimesë në përmbushjen e objektivave të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, sidomos në pikat që kanë të bëjnë me qartësimin e kompetencave në mes të nivelit qendror dhe lokal.

Duke qartësuar kompetencat dhe duke rritur vetëdijen qytetare për funksionimin e pushteteve, përmes hulumtimeve dhe disa raporteve të cilat do të pasojnë, Instituti GAP synon që të rritë angazhimin qytetar dhe presionin për ofrim të shërbimeve më të mira. Gjithashtu, përmes rritjes së informimit, projekti synon që në zgjedhjet e ardhshme komunale, qytetarët të japin votën duke qenë të vetëdijshëm për kompetencat e kryetarëve që ata zgjedhin.

## 2. Metodologjia


Ky hulumtim është zhvilluar në 38 komuna të Kosovës duke përdorur metodën sasiore të hulumtimeve. Për përcaktimin e mostrës në këtë hulumtim është përdorur teknika e “mostrës së shtresuar të rastit”, ku popullata e përgjithshme është ndarë në grupe më të vogla që njihen si shtresa – bazuar në karakteristikat e përbashkëta të pjesëtarëve të këtyre shtresave.

- **Shtresimi i parë:** është bërë në bazë të përkatësisë etnike, ku janë krijuar tri nën-grupe të ndryshme.


- **Shtresimi i dytë:** është bërë në bazë të vendbanimeve. Për secilën komunë është bërë ndarja e anketave në pjesët urbane dhe rurale, sipas statistikave zyrtare të ASK-se.
- **Shtresimi i tretë:** është bërë në bazë të numrit të anketave të realizuara në secilin vendbanim (pike startuese). Pikat startuese në këtë hulumtim janë përcaktuar sipas metodës së rastësisë.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar 1,000 qytetarë të Kosovës, të moshës mbi 18 vjeç – 750 shqiptarë, 150 serbë dhe 100 pjesëtarë të komuniteteve të tjera. Mostra më pas është peshuar, për të reflektuar strukturën etnike në Kosovë. Figura e mëposhtme paraqet numrin e intervistave të zhvilluara në shtatë regjionet kryesore të Kosovës.

**Figura 1.** Numri i intervistave të kompletuara sipas regjioneve



**Figura 2.** Ndarja e mostrës sipas gjinisë dhe etnisë



Anketimi është realizuar nga UBO Consulting nga data 14 deri më 25 janar 2017.

### 3. Njohuritë e qytetarëve për përgjegjësitë e nivelit qendror dhe lokal

Ky hulumtim ka për qëllim identifikimin e njohurive të përgjithshme të qytetarëve rreth përgjegjësisë të nivelit qendror dhe lokal. Më konkretisht, në këtë hulumtim është diskutuar rreth përgjegjësisë së nivelit qendror apo atij lokal për: mbledhjen e mbeturinave të lagjes; problemet me tension të lartë të rrymës; furnizimin me ujë të pijshëm; mirëmbajtjen e rrugëve; emërtimin e rrugëve; monitorimin e kualitetit të ajrit; problemet me afat të skaduar të produkteve; problemet me shërbimet zjarrfikëse; mbrojtjen e pyjeve; përzgjedhjen e mësimdhënësve në shkolla; hartimin e programeve mësimore; adresimin e shkeljeve të së drejtave të punëtorëve; pajisjen me dokumente të identifikimit; pajisjen me leje për operimin e gurëthyesve; sigurimin e barnave në qendrat mjekësore komunale; ndarjen e asistencës sociale; rritjen e pagave në sistemin arsimor dhe në sistemin shëndetësi. Përveç përgjegjësisë, qytetarët janë pyetur edhe për atë se kush do të duhej të ishte përgjegjës për këto fusha. Për dallim nga pyetjet mbi përgjegjësinë, këto pyetje shpalosin pritjet e qytetarëve për përgjegjësitë e ndryshme të institucioneve dhe jo njohurinë e tyre për to.


#### 3.1. Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave është kompetencë vetanake e komunave sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale.<sup>2</sup> Por në praktikë, më shumë se kompetencë vetanake, menaxhimi i mbeturinave bie në kompetencë të kompanive rajonale të cilat funksionojnë si shoqëri aksionare. Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, ekzistojnë 11 kompani të mbeturinave, në pesë prej të cilave komunat kanë pronësi 100% (Gjakova, Mitrovica Veriore, Zveçani, Leposaviçi dhe Zubin Potoku), kurse kompanitë tjera janë kompani rajonale, bordi i të cilave përbëhet nga dy e më shumë komuna.<sup>3</sup>

Përkundër besimit të kryetarëve të komunave se qytetarët kanë tendencë t'i fajësojnë ata edhe për çështjet të cilat nuk bien kryekëput në kompetencë të komunës, qytetarët kanë treguar njohuri mjaft të larta sa i përket përgjegjësisë për menaxhimin me mbeturina.

Kur janë pyetur se kush është përgjegjës për mbledhjen e mbeturinave në lagjen e tyre, rreth 49% e të anketuarve deklaruan se komuna dhe kompania rajonale e ndajnë këtë kompetencë (shih figurën 3). Për më tepër, 37% e të anketuarve e konsiderojnë vetëm kompaninë rajonale të mbeturinave si përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave në lagjen e tyre, ndërsa rreth 8% prej tyre e shohin si përgjegjëse vetëm komunën.

**Figura 3.** Ju lutem a mund të na tregoni se kush është përgjegjës për mbledhjen e mbeturinave në lagjen tuaj?



Mendimet e të anketuarve në lidhje me këtë çështje kanë dalluar dukshëm në bazë të etnisë. Siç mund të shihet në figurën 4, përdherisa rreth 67% e serbëve ndajnë mendimin


<sup>2</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale. Neni 17.

<sup>3</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike. I plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.05/L-009 dhe Ligjin nr.04/L-111. Burimi: <http://bit.ly/1vs647ë>



se vetëm komuna është përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave të lagjes, rreth 17% e të anketuarve shqiptarë dhe vetëm 6% e të anketuarve nga grupet e tjera etnike e ndajnë këtë mendim. Gjithashtu, asnjë nga të anketuarit serb nuk e konsiderojnë vetëm kompaninë rajonale të mbeturinave përgjegjëse për mbledhje të mbeturinave, ndërsa 38% e shqiptarëve ndajnë këtë opinion. Ky dallim në përgjigje në mes të komunitetit shqiptar dhe atij serb mund të jetë ndikuar edhe nga fakti se në komunat veriore me shumicë të komunitetit serb komuna është pronare e të gjitha aksioneve të kompanisë së mbeturinave.


**Figura 4.** Përgjegjësia për mbledhjen e mbeturinave: Ndarja në bazë të etnisë



Ndërsa, pyetur se kush do të duhej të ishte përgjegjës, në figurën 5 mund të shohim se rreth 60% e të anketuarve mendojnë se komuna bashkë me kompaninë rajonale duhet

të jenë përgjegjës kryesor për mbledhjen e mbeturinave në vendbanimin e tyre pavarësisht kompetencave momentale. Rreth 27% e qytetarëve mendojnë se përgjegjësi kryesor duhet të jetë vetëm kompania rajonale e mbeturinave, ndërsa 0.6% e të anketuarve ia japin këtë përgjegjësi vetë banorëve.

**Figura 5.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për mbledhjen e mbeturinave në lagjen/fshatin tuaj?




### 3.2. Furnizimi me ujë

Ashtu si me menaxhimin e mbeturinave, neni 17 i Ligjit për vetëqeverisje lokale lë në kompetencë të komunave furnizimin dhe menaxhimin me ujë. Por, në praktikë, furnizimi me ujë është kompetencë e ndërmarrjeve publike rajonale, të cilat funksionojnë si shoqëri aksionare dhe bordi i të cilave zgjidhet nga qeveria dhe komunat.<sup>4</sup>

Por, përkundër kësaj, pjesa dërmuese e qytetarëve janë të vetëdijshëm se kujt i bie përgjegjësia kryesore për furnizim me ujë. Shumica e të anketuarve besojnë se këtë përgjegjësi e ka kompania rajonale e ujësjellësit (80%), ndërsa rreth 13% e tyre e konsiderojnë komunën përgjegjëse në këtë drejtim. Gjithashtu, një përqindje e vogël e të anketuarve (5.5%) besojnë se furnizimi me ujë të pijshëm është përgjegjësi e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.


<sup>4</sup> Per me shume lidhur me zgjedhjen e bordeve shih analizen e Institutit GAP "Shërbimet publike komunale dhe ndërmarrjet publike. Burimi: <http://bit.ly/22PG54x>

**Figura 6.** Sipas jush, kush është përgjegjës për furnizim me ujë të pijshëm?



Të pyetur se kush do të duhej të ishte përgjegjës për furnizim me ujë, pa marrë parasysh kompetencat aktuale, pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se kompania rajonale e ujësjellësit duhet të jetë përgjegjëse për këtë çështje. Figura 7 tregon se 84% e të anketuarve janë përgjigjur në këtë mënyrë, ndërsa rreth 9% mendojnë se komuna është ajo që duhet të marrë përgjegjësi në raste të tilla.

**Figura 7.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për furnizimin me ujë të pijshëm?




### 3.3. Problemet me energji elektrike

Deri në privatizimin e rrjetit të energjisë dhe furnizimit më 2012, kompetencat e plota në furnizim dhe prodhim i takonin Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), ndërmarrje

publike nën menaxhim të qeverisë. Edhe pse energjia nuk ka qenë asnjëherë kompetencë e komunave, sipas një hulumtimi të Institutit GAP<sup>5</sup>, në periudhën 2009-2012, 21 komuna kishin investuar 800 mijë euro në rrjet të energjisë.

Të anketuarit u pyetën se kush është përgjegjës për adresimin e problemeve me tension apo tela të rrymës në lagjen e tyre. Siç mund të shihet në figurën 8, pjesa më e madhe e qytetarëve të anketuar (74%) mendojnë se KEDS si biznes privat është pala përgjegjëse për adresimin e këtyre problemeve, ndërsa rreth 20% e tyre ndajnë mendimin se këtë përgjegjësi e ka KEK-u si institucion publik.


**Figura 8.** Në rast se lagjja e juaj ka probleme me tensionin e lartë apo telat e rrymës, sipas jush kush është përgjegjësi kryesor për zgjidhjen e këtij problemi?



Pyetur se kush do të duhej të ishte përgjegjës për sa i përket problemeve me tensionin e lartë apo telat e rrymës, qytetarët kryesisht mendojnë se KEDS-i si biznes privat duhet të jetë përgjegjës për këtë çështje. Në figurën 8 më poshtë mund të shohim se përqindja e qytetarëve që e ndajnë këtë mendim është 74%, ndërsa rreth 21% mendojnë se përgjegjësia duhet të bie mbi KEK-un si institucion publik. Rreth 2% e të anketuarve e kanë cilësuar kryetarin e komunës si personin që do të duhej të ishte përgjegjës për këto probleme.

**Figura 9.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për problemet me tensionin e lartë apo telat e rrymës?

<sup>5</sup> Institutit GAP. Procesi i privatizimit dhe vlera e aseteve të KEDS. Tetor 2012. Burimi: <http://bit.ly/2mXNMs4> (hapur së fundmi më 5 mars 2017).




### 3.4. Mirëmbajtja dhe emërtimi i rrugëve lokale

Mirëmbajtja e rrugëve nacionale dhe regjionale bie në kompetencë të nivelit qendror, kurse mirëmbajtja e rrugëve lokale u takon komunave. Por në disa komuna, siç është shembulli i Komunës së Fushë Kosovës, rruga regjionale është pjesë kryesore e infrastrukturës së qytetit.

Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve lokale, rreth 60% e qytetarëve të anketuar deklaruan se kjo është kompetencë e komunës, 21% e tyre deklaruan se kjo është përgjegjësi e komunës dhe ministrisë, ndërsa rreth 15% e të anketuarve thanë se mirëmbajtja e rrugëve lokale është përgjegjësi e vetë banorëve (shih figurën 10).


**Figura 10.** Sipas jush, kush është përgjegjës për mirëmbajtjen e rrugëve lokale?



Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, emërtimi i rrugëve dhe vendbanimeve është kompetencë e komunave dhe pjesa më e madhe e qytetarëve janë në dijeni të kësaj. Kur janë pyetur se kompetencë e kujt është emërtimi i rrugëve në qytete dhe fshatra, shumica e qytetarëve të anketuar (85%) deklaruan se kjo është kompetencë e komunës. Për dallim, rreth 7% e të anketuarve ndanin mendimin se emërtimi i rrugëve është

kompetencë e qeverisë, ndërsa vetëm 5% e tyre deklaruan se kjo është kompetencë e Kuvendit të Kosovës (shih figurën 11).

**Figura 11.** A mund të na tregoni se kompetencë e kujt është emërtimi i rrugëve në qytete dhe fshatra?



Ndërsa, në figurën 12 më poshtë janë paraqitur rezultatet për pritjet e qytetarëve rreth përgjegjësit kryesor për problemet me mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Pak më shumë se gjysma e të anketuarve, rreth 55% mendojnë se komuna duhet të jetë përgjegjësi kryesor për sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve lokale, ndërsa 26% të tjerë janë të mendimit se komuna së bashku me ministrinë duhet ta kenë këtë detyrë.

**Figura 12.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për mirëmbajtjen e rrugëve lokale?





Figura 13 më poshtë tregon se kur bëhet fjalë për emërimin e rrugëve në qytete e fshatra, pjesa dërrmuese e të anketuarve (88%) mendojnë se komuna duhet të jetë përgjegjëse për këtë detyrë pa marrë parasysh përgjegjësitë aktuale. Një pjesë e vogël e qytetarëve, rreth 5.5% mendojnë se qeveria duhet ta ketë këtë detyrë, si dhe një pjesë pothuajse e barabartë do t'ia linin këtë përgjegjësi Kuvendit të Kosovës.

**Figura 13.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për emërimin e rrugëve në qytete dhe fshatra?




### 3.5. Kompetencat në arsim

Përzgjedhja e stafit mësimdhënës në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm është kompetencë e komunave, kurse hartimi i planprogrameve mësimore është kompetencë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Por në përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave në komisionin intervistues prej tre anëtarëve, MASHT delegon një anëtar, kurse dy të tjerët caktohen nga kryetari i komunës.<sup>6</sup>

Siç mund të shihet në figurën 14, rreth 49% e të anketuarve besojnë se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse për përzgjedhjen e mësimdhënësve, ndërsa rreth 33% e tyre deklaruan se këtë përgjegjësi e ka komuna. Gjithashtu, disa prej të anketuarve (9%) thanë se përzgjedhja e mësimdhënësve është përgjegjësi e vetë shkollave, ndërsa një përqindje e vogël e të anketuarve (4%) deklaruan se këtë kompetencë e ka Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë.

**Figura 14.** Sipas jush, kush e ka përgjegjësinë e përzgjedhjes së mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme?


<sup>6</sup>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Udhëzimi administrative i MASHT nr.08/2014 procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues. Burimi: <http://bit.ly/2nk3vV0> (hapur së fundmi më 21 mars 2017).



Në pyetjen për përzgjedhjen e mësimdhënësve kishte dallime të dukshme të mendimeve në bazë të nivelit të edukimit të qytetarëve të anketuar. Siç mund të shihet në figurën 15, përqindja e qytetarëve që mendonin se përzgjedhja e mësimdhënësve është kompetencë e komunës rritet sipas nivelit të edukimit. Përderisa 28% e të anketuarve që kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë apo më pak mendonin se komuna e ka këtë përgjegjësi, 39% e atyre me shkollë të lartë apo që janë studentë, dhe 47% e të anketuarve që kishin përfunduar studimet Bachelor apo më shumë, e ndanin këtë mendim. Një trend i ngjashëm, por në drejtim të kundërt, mund të vërehet edhe në mendimet e qytetarëve që kishin qarkuar MASHT-in si përgjegjëse për zgjedhjen e mësimdhënësve në shkolla. Derisa 53% e të anketuarve që kishin përfunduar shkollën e mesme të lartë apo më pak mendonin se këtë përgjegjësi e ka MASHT, 37% e atyre me studime Bachelor apo nivel më të lartë të edukimit ishin të këtij opinionioni.


**Figura 15.** Përgjegjësia për përzgjedhjen së mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme: Ndarja në bazë të nivelit të edukimit






Qytetarët janë kërkuar të tregojnë pritjet e tyre se cili nga institucionet duhet ta ketë përgjegjësinë kryesore për përzgjedhjen e mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme. Në figurën 16 më poshtë janë përmbledhur rezultatet e dala nga përgjigjet. Pjesa më e madhe e tyre, rreth 45%, mendojnë se kjo detyrë duhet të jetë përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Një pjesë tjetër e të anketuarve, afër 30%, e cilësojnë komunën si institucionin që duhet të ketë rolin kryesor në këtë çështje pavarësisht kompetencave ekzistuese. Për më tepër, akterë të tjerë që mendohet se duhet të jenë përgjegjësit kryesorë në lidhje me përzgjedhjen janë shkolla (12%), këshilli i prindërve (6%) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (5%).

**Figura 16.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për përzgjedhjen e mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme?




Për më tepër, të anketuarit janë pyetur nëse rritja e pagave në sistemin arsimor është përgjegjësi e komunës. Siç mund të shihet në figurën 17, shumica e të anketuarve (70.5%) deklaruan se kjo nuk është kompetencë e komunës. Për dallim, rreth 17% e tyre ishin të mendimit se komuna ka kompetencë rritjen e pagave në sistemin arsimor, ndërsa rreth 13% të qytetarëve të anketuar nuk kishin njohuri në këtë drejtim.

**Figura 17.** Sipas jush, a është rritja e pagave në sistemin arsimor kompetencë e komunës?



Kur janë pyetur se kush sipas tyre është përgjegjës për hartimin e programeve në shkolla, shumica e të anketuarve (72%) u pajtuan se këtë përgjegjësi e ka MASHT-i, ndërsa rreth 10% e tyre besonin se programet mësimore janë përgjegjësi e komunës (shih figurën 18). Një tjetër 10% e të anketuarve mendonin se këtë kompetencë e ka Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë dhe një përqindje mjaft e vogël e të anketuarve ishin të mendimit se këtë përgjegjësi e kanë vetë shkollat.

**Figura 18.** Sipas jush, kush është përgjegjës për programet mësimore në shkolla?




### 3.6. Mbrojtja e ajrit dhe e pyjeve

Më pas, qytetarët janë pyetur se kush është sipas tyre përgjegjës për monitorimin e kualitetit të ajrit si dhe kush është përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale. Sipas Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, përgjegjësia kryesore për monitorimin e

cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e ajrit nga ndotja bie mbi Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Por komunat janë përgjegjëse për hartimin e planeve lokale për cilësinë e ajrit, të cilat duhet të përputhen me strategjinë nacionale për cilësinë e ajrit.<sup>7</sup> Në vitin 2016, Komuna e Prishtinës dhe ajo e Gjakovës kanë vendosur matës për monitorimin e ajrit. MMPH kishte reaguar duke kërkuar nga këto dy komuna që të largojnë matësit me arsyetimin se ato nuk janë të kalibruar dhe se i vetmi burim zyrtar për matjen dhe informimin për kualitetin e ajrit është Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në kuadër të MPMH.<sup>8</sup>

Të pyetur për monitorimin dhe raportimin për kualitetin e ajrit, rreth 63% e të anketuarve deklaruan se monitorimi i kualitetit të ajrit është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa 18% e tyre ishin të mendimit se kjo është përgjegjësi e përbashkët e ministrisë dhe komunës (shih figurën 19). Një pjesë më e vogël e të anketuarve e konsideronin vetëm komunën përgjegjëse në këtë drejtim.

**Figura 19.** Sipas jush, kush është përgjegjës për monitorim dhe raportim për kualitetin e ajrit?



Mbrojtja e pyjeve është kompetencë e komunave në bazë të kompetencave të deleguara.<sup>9</sup> Por mbikëqyrja inspektuese i takon inspektoratit të tregut dhe inspektorati i pylltarisë i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).<sup>10</sup> Që nga viti 2010, edhe

<sup>7</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-130 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Neni 31. Burimi: <http://bit.ly/2o8IfyT> (hapur së fundmi më 2 mars 2017).

<sup>8</sup> Një përgjigje për këtë e ka dhënë edhe ish-ministri i MMPH z.Ferid Agani gjatë një konference ndërkombëtare, mbajtur më 26 prill 2016, në Hotel Emerald në Prishtinë, nën organizimin e Balkan Green Foundation. Burimi: <http://bit.ly/2nGRPg8>, nga minuta 1.10.00 (hapur së fundmi më 22 mars 2016).


<sup>9</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale. Neni 18.

<sup>10</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për pyjet. Neni 12, i cili plotëson nenin 29, pika 11 të Ligjit për pyje. Burimi: <http://bit.ly/2mYc6Kh> (hapur së fundmi më 12 mars 2017).

inspektorati i tregut ka kaluar në nivelin qendror, respektivisht në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.<sup>11</sup>

Të pyetur se kush është përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale, 64% e të anketuarve deklaruan se kjo është kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Një pjesë tjetër e të anketuarve deklaruan se kjo është përgjegjësi e komunës (17%) dhe e Policisë së Kosovës (17%).

**Figura 20.** Kush është përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale?



Pyetur se kush do të duhej të ishte përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e kualitetit të ajrit, ata kryesisht mendojnë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të jetë në rolin e përgjegjësit kryesor për problemet lidhur me këtë çështje. Më saktësisht, në figurën 21 më poshtë mund të shihet se 66% e kanë dhënë këtë mendim, ndërsa 24% të tjerë janë të mendimit se ministria së bashku me komunën duhet ta mbajnë këtë përgjegjësi.

**Figura 21.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për monitorimin dhe raportimin për kualitetin e ajrit?

<sup>11</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-181 për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut. Burimi: <http://bit.ly/2nH1ALZ>. Në 2015, Instituti GAP ka analizuar konfliktin e kompetencave sa i përket inspektoratit të tregut në analizën me titull "Ndarja e përgjegjësiave në inspektim në mes të nivelit qendror dhe lokal". Burimi: <http://bit.ly/2mëjEb7> (hapur së fundmi më 15 shkurt 2017).





Figura 22 paraqet pritjet e të anketuarve në lidhje me përgjegjësin kryesor për problemet me mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale. Një pjesë e konsiderueshme e tyre, 63%, mendojnë se pavarësisht kompetencave momentale është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ajo që duhet të merret me këto probleme. Një pjesë tjetër e qytetarëve, rreth 25%, në fakt e shohin Policinë e Kosovës si institucionin përgjegjës për çështjet lidhur me pyjet.

**Figura 22.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale?



### 3.7. Kompetencat në shëndetësi


Përkujdesi shëndetësor primar është kompetencë e komunave, kurse shëndetësia sekondare (spitalet regjionale) dhe terciare (Qendra Klinike Universitare e Kosovës) janë kompetencë e nivelit qendror. Përjashtim nga ky rregull bëjnë komuna e Mitrovicës Veriore, Graçanicës dhe Shtërpçës, të cilat me kompetencat e zgjeruara që i jep Ligji për vetëqeverisje lokale, ofrojnë edhe kujdesin shëndetësor dytësor.<sup>12</sup> Përderisa komunat

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale. Neni 20. Burimi: <http://bit.ly/1CuIaKA> (hapur së fundmi më 22 mars 2017).

janë përgjegjëse për përzgjedhjen e stafit, menaxhimin e qendrave të mjekësisë familjare dhe sigurimin e cilësisë së shërbimeve, Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për hartimin e listës dhe sigurimin e barnave esenciale, si dhe vendos për nivelin e pagave në këtë sektor.


Për të matur njohuritë e qytetarëve për kompetencat në fushën e shëndetësisë, të anketuarit janë pyetur për listën esenciale të barnave dhe pagat në këtë sektor. Pjesa më e madhe e të anketuarve (88%) deklaruan se Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për sigurimin e barnave nga lista esenciale, kurse një pjesë e qytetarëve të anketuar (9%) ishin të mendimit se këtë përgjegjësi e ka komuna.

**Figura 23.** Cili institucion është përgjegjës për sigurimin e barnave nga lista esenciale nëpër qendrat mjekësore në komunën tuaj?




Të anketuarit janë pyetur për pritjet e tyre se kush do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për problemet me sigurimin e barnave nga lista esenciale. Figura 26 më poshtë tregon se një shumicë e theksuar e qytetarëve (89%) mendojnë se kjo detyrë duhet t'i lihet nën përgjegjësi Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa vetëm 8% e tyre e shohin komunën si një institucion që do të duhej të ishte përgjegjës për problemet lidhur me barnat e listës esenciale.

**Figura 24.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për sigurimin e barnave nga lista esenciale?



Në lidhje me rritjen e pagave në sistemin shëndetësor, shumica e të anketuarve (70%) nuk u pajtuan se kjo është kompetencë e nivelit lokal, përkatësisht e komunës (shih figurën 24). Për dallim, 13% e të anketuarve deklaruan se kjo është kompetencë e komunës, ndërsa 17% e tyre nuk kishin njohuri në lidhje me këtë çështje.

**Figura 25.** Sipas jush, a është rritja e pagave në sistemin shëndetësor kompetencë e komunës?



### 3.8. Ndarja e ndihmës sociale


Ndihmat sociale ndahen konform Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.<sup>13</sup> Deri më 2012, kjo kompetencë i takonte vetëm Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Me ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale<sup>14</sup>, MPMS këto kompetenca i delegoi tek komunat. Komunat përzgjedhin udhëheqësit e shërbimit të ndihmës sociale, si dhe përzgjedhin familjet të cilat përfitojnë ndihmë sociale. Edhe pse përzgjedhja e përfituesve të ndihmës sociale bëhet nga komuna, MPMS shpërndan pagesat.

<sup>13</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale. Burimi: <http://bit.ly/2ocuEXq> (hapur së fundmi më 23 mars 2017).

<sup>14</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/15 për skemën e ndihmës sociale. Burimi: <http://bit.ly/2nYë9cH> (hapur së fundmi më 23 mars 2017).


Shumica e qytetarëve të anketuar (79%) deklaruan se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ndan ndihmën sociale, ndërsa 16% e tyre ishin të mendimit se kjo është përgjegjësi e komunës (shih figurën 26).

**Figura 26.** Sipas jush, cili institucion ndan ndihmën sociale?



Të anketuarit janë pyetur për mendimin e tyre mbi institucionin që do të duhej të ishte përgjegjësi kryesor për ndarjen e ndihmës sociale. Figura 27 më poshtë tregon se 75% e tyre presin që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të vazhdojë të mbaj këtë përgjegjësi. Rreth 18.5% të tjerë nuk ndajnë të njëjtin mendim dhe e shohin komunën si institucion përgjegjës për këtë çështje. Një pjesë e vogël e të anketuarve (4%) janë përgjigjur se Kuvendi i Kosovës do të duhej të ishte përgjegjës për problemet me ndarjen e ndihmës sociale pavarësisht kompetencave aktuale.

**Figura 27.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për ndarjen e ndihmës sociale?






### 3.9. Mbrojta e të drejtave të punëtorëve dhe konsumatorëve

Ligji i punës definon të drejtat e punëtorëve dhe procedurat e ankesës në rast se ato të drejta shkelen nga punëdhënësi. Sipas këtij ligji, Inspektorati i Punës është adresa në të cilën të punësuarit në çdo kohë mund të parashtrajnë ankesë ndaj punëdhënësit.<sup>15</sup> Inspektorati i Punës është agjencion ekzekutiv në kuadër të MPMS.

Për adresimin e shkeljeve të drejtave të punëtorëve, rreth 43% e të anketuarve u pajtuan se për këto çështje do t'i drejtoheshin MPMS-së, ndërsa 31% e qytetarëve të anketuar thanë se këtë përgjegjësi e ka Sindikata. Një pjesë më e vogël e të anketuarve (14%) ishin të mendimit se ankesat për shkelje të drejtave të punëtorëve duhet t'i parashtrohen komunës dhe disa të tjerë thanë se ankesat për këtë çështje duhet të paraqiten në Kuvendin e Kosovës (shih figurën 28).

**Figura 28.** Ju lutem a mund të na tregoni se në cilin institucion duhet ankuar në rast të shkeljes së të drejtave të punëtorëve?




Sa i përket të drejtave të konsumatorëve, Ligji për mbrojtjen e konsumatorit vendos të drejtat e konsumatorëve dhe detyrimet e operatorëve ekonomik. Sipas këtij ligji, në rast të ankesave, konsumatorët mund t'i drejtohen strukturave përgjegjëse në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.<sup>16</sup>

<sup>15</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-212 i punës. Neni 82. Burimi: <http://bit.ly/2nPI809> (hapur së fundmi më 2 mars 2017).

<sup>16</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-121 për mbrojtjen e konsumatorit. Neni 8. Burimi: <http://bit.ly/2njKd29> (hapur së fundmi më 12 shkurt 2017).

Për të matur njohuritë e qytetarëve rreth adresës së ankesës në rast të pakënaqësive me bizneset, i kemi pyetur ata për një problem bazik, siç mund të jetë shitja e produkteve me afat të skaduar. Rreth 33% e të anketuarve deklaruan se nëse do të hasnin në produkte me afat të skaduar do t'i drejtoheshin kompanisë private përgjegjëse për këtë çështje. Në anën tjetër, rreth 28% e qytetarëve të anketuar thanë se do t'i drejtoheshin Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për këtë çështje. Gjithashtu, rreth 17% e të anketuarve deklaruan se për problemet me afat të skaduar të produkteve do t'i drejtoheshin vetëm komunës, ndërsa 12% komunës dhe ministrisë.

**Figura 29.** Nëse do të hasni në produkte me afat të skaduar në treg, kujt do ti drejtoheshit së pari?




### 3.10. Operimi i gurëthyesve

Në disa komuna, qytetarët përballen me pluhurin, zhurmën dhe dëme materiale në shtëpi të banimit, si pasojë e operimit të gurëthyesve ose shfrytëzuesit e zhavorit. Gurët, rëra, zhavori e materiale tjera si këto konsiderohen minerale ndërtimore dhe lejet për shfrytëzimin e tyre jepen nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), agjencion i pavarur i themeluar me Ligjin për miniera dhe minerale<sup>17</sup> dhe i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Por, operatorët që aplikojnë për licencë në KPMM, duhet së pari të marrin një pëlqim nga komuna dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kur janë pyetur se cili institucion jep lejet për operimin e gurëthyesve 36% e të anketuarve deklaruan se këtë leje e lëshon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, rreth 32% e tyre ishin të mendimit se këtë kompetencë e ka Komisioni për Miniera dhe Minerale, dhe 19% e të anketuarve thanë se këto leje i jep komuna (shih figurën 30).


<sup>17</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/L-163 për minierat dhe mineralet. Burimi: <http://bit.ly/2nLcP53> (hapur së fundmi më 25 shkurt 2017).

**Figura 30.** Cili institucion jep lejet për operimin e gurëthyesve?



Kur bëhet fjalë për pritjet rreth dhënies së lejeve për operimin e gurëthyesve, figura 31 më poshtë tregon se rreth 41% e të anketuarve mendojnë se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të duhej ta kishte këtë përgjegjësi, ndërsa 36% kanë përzgjedhur si përgjigje Komisionin për Miniera dhe Minerale.

**Figura 31.** Pavarësisht kompetencave momentale, a mund të na tregoni se cili institucion do të duhej të ishte përgjegjës kryesor për dhënien e lejeve për operimin e gurëthyesve?



### 3.11. Kompetencat për shërbimin e zjarrfikësve

Reagimi ndaj rasteve emergjente lokale është një nga kompetencat vetanake të komunave.<sup>18</sup> Një ndër emergjencat më të shpeshta është edhe shpërthimi i zjarreve. Shërbimi i zjarrfikësve është një ndër institucionet reaguese në raste të emergjencave. Por, zjarrfikësit menaxhohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, përmes Agjencisë së

<sup>18</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale. Neni 17. Burimi: <http://bit.ly/1CuIaKA> (hapur së fundmi më 22 mars 2017).


Menaxhimit Emergjent, kurse pagesa e pagave të shërbimit të zjarrfikësve bëhet nga ana e komunave.<sup>19</sup>

Kur qytetarët u pyetën se mbi kë bie përgjegjësia nëse Shërbimi i Zjarrfikësve nuk i përgjigjet thirrjes për intervenim, rreth 41% e të anketuarve deklaruan se përgjegjësia bie mbi kryetarin e komunës, ndërsa 34% e tyre ishin të mendimit se përgjegjësia bie mbi Ministrinë e Punëve të Brendshme (shih figurën 32).

**Figura 32.** Mbi kë bie përgjegjësia, në rast se Shërbimi i Zjarrfikësve nuk i përgjigjet thirrjes për intervenim?

---


<sup>19</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-049 për zjarrfikje dhe shpëtim. Neni 7. Burimi: <http://bit.ly/1UUiqZv> (hapur së fundmi më 21 mars 2017).



### 3.8. Nxjerrja e dokumenteve personale

Pajisja e qytetarëve me letërnjoftim dhe pasaportë është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Të pyetur se ku duhet aplikuar për t’u pajisur me pasaportë dhe letërnjoftim, rreth 52% e të anketuarve deklaruan se kjo është kompetencë e nivelit lokal, përkatësisht komunës. Rreth 34% e të anketuarve ishin të mendimit se këto dokumente lëshohen nga Ministria e Punëve të Brendshme. Gjithashtu, 13% e të anketuarve deklaruan se këtë përgjegjësi e ka Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**Figura 33.** Ju lutem a mund të na tregoni se në cilin institucion duhet aplikuar për tu pajisur me letërnjoftim apo pasaportë?



## Përfundimi

Për përgatitjen e pyetjeve për anketim, Instituti GAP ka mbajtur një fokus grup me përfaqësues të MAPL dhe komunave. Në këtë fokus grup ka ekzistuar skepticizëm se pyetjet e adresuara ndaj qytetarëve janë shumë të avancuara dhe “shumë prej këtyre pyetjeve do kishin vështirësi t'i përgjigjeshin edhe vetë zyrtarët komunal”. Por rezultatet e hulumtimit në masë të madhe dëshmojnë të kundërtën: qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme për institucionet përgjegjëse për adresimin e politikave në fusha të ndryshme të jetës publike.

Por nuk do të ishte çudi edhe nëse qytetarët nuk do ishin në dijeni për kompetencat e nivelit qendror dhe lokal. Legjislacioni në fuqi ka krijuar një ndërthurje të kompetencave në mes të dy niveleve, aq sa në disa raste kundërshtimet në mes të nivelit qendror dhe atij lokal kanë bllokuar shumë politika. Një gjë e tillë ka ndodhur sidomos në Komunën e Prishtinës. Kompetencat vetanake të komunave, të listuara në nenin 17 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, në praktikë nuk janë kompetenca vetanake, por një ndërthurje në mes të pushtetit të komunave, ministrive, ndërmarrjeve publike dhe agjencioneve të pavarura.

Por, përkundër asaj se shumica e qytetarëve janë të informuar për shumicën e politikave publike dhe përgjegjësit për to, njohuritë e qytetarëve dallojnë në disa raste në baze të etnisë, moshës, apo nivelit të edukimit. Për shembull, një rast i tillë ku niveli i informimit të qytetarëve dallon në bazë të nivelit të edukimit mund të vërehet tek pyetja se kush është përgjegjës për emërimin e mësimit në shkollë filllore dhe të mesme. Pothuajse gjysma e të anketuarve deklaruan se këtë përgjegjësi e ka MASHT-i, ndërsa 33.5% ishin të vetëdijshëm se këtë kompetencë e ka komuna. Mirëpo, niveli i informimit të qytetarëve në këtë drejtim dallonte në bazë të nivelit të edukimit. Më shumë nga qytetarët me nivel më të lartë të edukimit ishin saktë të informuar për këtë çështje dhe më shumë nga të anketuarit që besonin se kjo është përgjegjësi e nivelit qendror kishin nivel më të ulët të edukimit. Për më tepër, dallime më të theksuara në mes të qytetarëve kishte në bazë të etnisë. Një shembull i tillë mund të shihet tek pyetja për mirëmbajtjen e mbeturinave ku prej atyre që besonin se këtë përgjegjësi duhet ta ketë vetëm komuna, vetëm 7% ishin shqiptarë dhe 67% ishin serb.


Një nga mësimet që mund të nxirret nga ky hulumtim është se krahas edukimit të qytetarëve për kompetencat e komunave dhe adresat për të kërkuar llogaridhënie, nevojitet një plan nacional për eliminimin e kundërthënies ligjore dhe adresimin e përgjegjësive, duke eliminuar burokracinë dhe pengesat në komunikim në mes të institucioneve të të dy niveleve.

Bazuar në rezultatet e këtij hulumtimi, në bashkëpunim me institucionet publike dhe mediat, Instituti GAP do të ndërmarrë një fushatë informimi për të ngritur nivelin e vetëdijes edhe për ato politika për të cilat qytetarët nuk kanë treguar njohuri të mjaftueshme, si për shembull adresimi i qartë i përgjegjësive për nxjerrjen e dokumenteve personale, si letërnjoftimi dhe pasaporta, për të cilat qytetarët mendojnë se komuna është përgjegjëse për lëshimin e tyre. Përveç kësaj, thuhet në secilën pyetje, ekziston një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve të cilët nuk kanë njohuri për kompetencat e komunave, e me të cilët do të duhej të punohej më shumë në programe të edukimit publik.





Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbytja e këtij botimi është përgjegjësi e **Institutit GAP** dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Instituti GAP mbështetet nga:

